2	Pergjegjese Finance	1	III	III-2	1			pika 3, ç		70,000
3	Specialist Finance	2	IV	IV-2	1 ose 2 ose 3			pika 3, ç		50,000
4	Magaznier	1		pika 11				1%		47,000
5	Specialiste e Arsimit	1	IV	IV-2	1 ose 2 ose 3			pika 3, ç		47,000
6	Shofer	1		pika 11				1%		47,000
<b>SEKTOR NDIHMES</b>										
1	Sanitare (me kontrate)(8 ore/dite)	4		pika 11				1%		47,000
2	Sanitare (me kontrate)(6 ore)	5		pika 11				1%		47,000
3	Sanitare (me kontrate) (4 ore)	7		pika 11				1%		47,000
4	Sanitare (me kontrate) ( 2 ore )	2		pika 11				1%		47,000
5	Rofe	1		pika 11				1%		47,000
<b>SEKTORI I ÇERDHEVE</b>										
1	Pergjegjese	1	III	III-3	1			pika 3, ç		65,000
2	Edukatore çerdhe	14		pika 11				1%		47,000
3	Kuzhiniere	3		pika 11				1%		47,000
4	Ndihmes/ Kuzhiniere	1		pika 11				1%		47,000
5	Sanitare	4		pika 11				1%		47,000
<b>SEKTORI I SHUME SPORTEVE</b>										
1	Pergjegjese sektori	1	III	III-3	1			pika 3, ç		65,000
2	Mirembaites i terreneve sportive	4		pika 11				1%		47,000



SEKRETAR I KESHILLIT BASHKIAK  
BUXHETIT

Alda HODO



DREJTOR I FINANCES DHE

Heroina SHKEMBI

P/ BURIMEVE NJEREZORE  
MBNJ

Klevi LACE



DREJTOR I DREJTORISE JURIDIKE DHE

Erion PLAKU



KRYETARI I BASHKISE

Kreshnik HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KUCOVE

DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

## RELACION

PER

**NJE NDRYSHIM NE VKB NR. 45 DATE 20.12.2023 MBI "KATEGORIZIMIN E NIVELIT TE PAGAVE TE PUNONJESVE TE ZGJEDHUR DHE TE EMERUAR, NEPUNESVE CIVILE SI DHE TE PUNONJESVE ADMINISTRATIVE TE BASHKISE DHE NJESIVE TE SAJ NE VARESI PER VITIN 2024".**

### **Të nderuar Këshilltarë !**

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 503, datë 01/08/2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr 328 date 31/05/2023 ,te Keshillit te Ministrave "Per klasifikimin e Funksioneve ,Grupimin e Njesive te Veteqeverisjes Vendore ,per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te Funksionareve te Zgjedhur e te emeruar ,te Nepunesve Civile e te punonjesve Administrative te Njesive te Veteqeverisjes Vendore ",ka miratuar nivelet e reja te pagave dhe menyren e perllogaritjes se vjetersise per punonjesit ,cka do te thote qe institucioni i Bashkise Kucove kalon ne nje faze te re dhe moment te rendesishem per sa i perket trajtimit financiar te punonjesve sipas pozicioneve te punes qe ata kane.Me shkresen nr 11788 prot date 04/09/2024 ,eshte derguar fondi per rritjen e niveleve te pagave sipas kufirit te ri minimal.Hyrja ne kete faze te re do te thote nje page dinjitoze per punonjesit dhe sherbime me te mira per qytetaret.

Bashkia Kucove nder te tjera, me nivelet e reja te pagave de fakto ka arritur te realizoje edhe unifikimin e pagave sipas nivelit dhe pozicionit te punes se cdo punonjesi.

Ne piken 1 germa (ç) te ketij vendimi eshte percaktuar edhe shtesa per vjetersi e cila llogaritet mbi pagen e pozicionit si dhe e llogaritur ne perqindje do te jete; 0.6 % pas çdo viti pune per 10 (dhjete ) vitet e para (1-10 vite) , 0.8 % pas çdo viti pune per 10 (dhjete) vitet e dyta ( 11-20 vite), dhe 1 % pas çdo viti pune per 10 vitet e treta (21- 30 vite).

-Nivelet e reja te pagave te punonjesve te Bashkise si dhe Njesive ne varesi jane te pasqyruara ne strukturen e pagave e cila gjendet bashkelidhur projekt – vendimit i cili eshte paraqitur per miratim .



Sa me siper kerkojme nga Keshilli Bashkiak miratimin e niveleve te reja te pages sipas percaktimeve perkatese.

Duke ju falenderuar !

Per Drejtorine Juridike dhe Menaxhimit te Burimeve Njerezore

Konc;

Klevi Laca



Miratoi:

Erion Plaku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KUÇOVË  
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nr. Prot 2/51

Kuçovë, më 19/09/2024

**Lënda:** Dërgim i raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-Gusht 2024.

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak

Kuçovë

Të nderuar,

Në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 68, dt. 24.07.2017 "Për financat e Qeverisjes Vendore", udhëzimit nr. 22, date 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", bashkëlidhur ju dërgojmë raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-Gusht 2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Kryetari i Bashkisë  
Kreshnik HAJDARI





**RAPORT MONITORIMI I ZBATIMIT TË BUXHETIT  
JANAR – GUSHT 2024  
BASHKIA KUÇOVË**

-	HYRJE.....	2
-	REALIZIMI I TË ARDHURAVE NGA BURIMET E VETA.....	6
	Realizimi i të ardhurave të veta	
	Të ardhura nga taksat vendore	
	Të ardhura nga tarifat vendore	
	Të ardhura nga taksat e ndara	
	Të ardhura të tjera	
-	FUNKSIONI 011: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE	
	Programi 01110: Planifikim, menaxhim, administrim.....	4
-	FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	
-	Programi 03140: Shërbimet e Policisë Vendore.....	11
-	Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile .....	12
-	FUNKSIONI 04: BUJQËSIA, PYJET, PESHKIMI DHE GJUETIA	
	Programi 04220: Shërbimet bujqësore.....	14
	Programi 04240: Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit .....	14
	Programi 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave .....	14
-	NËNFUNKSIONI 045: TRANSPORTI	
	Programi 04520: Rrjeti rrugor.....	22
-	FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT	
	Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve.....	15
-	FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETE E KOMUNITETIT	
	Programi 06140: Planifikimi urban vendor.....	19
	Programi 06260: Shërbime publike vendore.....	20
-	FUNKSIONI 08: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA	
	Programi 08130: Sport dhe argëtim.....	23
	Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore.....	26
-	FUNKSIONI 09: ARSIMI	
	Programi 09120: Arsimit bazë dhe parashkollor.....	23
	Programi 09230: Arsimit mesëm i përgjithshëm.....	23
-	FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE	
	Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët.....	25
-	REALIZIMI I SHPENZIMEVE.....	anex 1&2
-	REALIZIMI I INVESTIMEVE.....	4
-	VETËVLERËSIMI FINANCIAR.....	
-	TREGUESIT FINANCIARË.....	anex 5



## HYRJE

Raporti i monitorimit të Buxhetit është në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, të ligjit nr. 9632 datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar, ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe udhëzimit nr. 22 dt. 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.

**Misioni i Bashkisë Kuçovë:** Bashkia Kuçovë, përtej qëllimit ekonomik, synon të krijojë një mjedis shoqëror të shëndetshëm nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron; ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë, sot e në vazhdim.

### Vizioni i Bashkisë Kuçovë:

“Kuçova udhëhiqet nga synimi madhor për një zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, ekonomik dhe mjedisor të territorit të saj, përmes mbështetjes së ekonomisë lokale, rimëkëmbjes së aktiviteteve urbane dhe ndërveprimit shoqëror për të mirën e përbashkët. Ky zhvillim do të arrihet duke mbrojtur burimet natyrore, si ato me rëndësi kombëtare dhe ato me rëndësi lokale, përfshirë hapësirat publike dhe kulturën e traditën vendore të zonës, me qëllimin kryesor për një të ardhme sa më të qëndrueshme edhe për brezat e ardhshëm.

Buxheti i Bashkisë Kuçovë për vitin 2023, është miratuar sipas V.K.B, nr. 47, dt. 20.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr. 900/1 dt. 08.01.2024, i ndryshuar me VKB nr. 13, dt. 27.02.2024 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr. 169/1 dt. 29.02.2024.

Paketa fiskale, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.37 date 30.11.2023, “Mbi Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kuçovë për vitin 2024”.

Bashkia Kuçovë është e organizuar në katër njësi shpenzuese: Bashkia Kuçovë, Qendra Ekonomike e Arsimit, Ndërmarrja Komunale dhe Qendra Kulturore.

Bashkia Kuçovë administron dhe menaxhon fondet sipas programeve në vijim.

### "Raporti i Monitorimit të Shpenzimeve sipas Programeve Janar-Gusht 2024"

Anex1		Buxheti i financuar me fondet e veta					ne leke			
Emri i Grupit		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	Kodi i Grupit			
Programi							Kodi i Programit			
Titulli	Emertimi Programit	Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	PBA Plan Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes	Fakti Periudhes	(7)=(6)-(5)	Diferenca	Realizimi ne%
01110	Planifikim, menaxhim, administrim.	56,765,806	84,515,542	84,515,542	99,691,504	63,259,827	41,854,252	21,405,575	66	
03140	Sherbime të Policise Vendore	4,846,368	6,285,000	6,285,000	6,878,000	4,585,333	3,262,076	1,323,257	71	
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	16,728,896	22,063,000	22,063,000	26,079,379	17,396,253	11,475,565	5,920,688	66	
04220	Sherbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	4,872,667	5,740,000	5,740,000	6,034,003	4,022,669	3,686,553	336,116	92	
04240	Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	13,102,597	15,486,423	15,486,423	19,203,708	11,680,683	7,348,362	4,332,321	63	
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	3,952,771	5,026,000	5,026,000	7,614,444	4,309,629	3,207,664	1,101,965	74	
04520	Mirembajtje rrugë e trotuare	127,221,546	96,108,020	96,108,020	106,384,685	75,707,000	69,734,080	5,972,920	92	
05100	Menaxhimi i mbetjeve	38,794,913	52,369,748	52,369,748	53,042,671	35,361,781	33,966,493	1,395,288	96	
06140	Planifikimi urban vendor	10,222,961	12,803,000	12,803,000	13,279,000	8,852,667	7,038,117	1,814,550	80	



06190	Banesa sociale	4,748,325	2,269,381	2,269,381	0	0	0	0	0
06210	Zhvillimi i komunitetit	37,634,832	16,000,000	16,000,000	0	0	0	0	0
06260	Sherbimet publike vendore	56,873,479	112,417,843	112,417,843	124,635,982	62,913,259	40,903,873	22,009,386	65
08130	Sport dhe argetim	16,677,351	13,723,000	13,723,000	13,916,000	10,627,333	10,420,910	206,423	98
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	11,490,817	12,427,000	12,427,000	13,799,340	8,304,893	8,205,085	99,808	99
09120	Arsimi parashkollor, baze&OKF	124,466,143	143,887,717	143,887,717	168,642,345	93,974,667	92,333,450	1,641,217	98
09230	Arsimi i mesem	8,016,356	8,372,366	8,372,366	8,372,366	5,528,700	5,528,210	490	100
10430	Mbrojtja sociale	27,519,342	33,039,677	33,039,677	35,212,449	22,874,966	20,390,929	2,484,037	89
10661	Strehimi social	0	0	0	2,756,061	0	0	0	
	<b>Totali</b>	<b>563,935,170</b>	<b>642,533,717</b>	<b>642,533,717</b>	<b>705,541,937</b>	<b>429,399,659</b>	<b>359,355,619</b>	<b>70,044,040</b>	<b>84</b>

**"Raporti i Monitorimit të Shpenzimeve sipas Artikujeve Janar-Gusht 2024"**

Anex2		Buxheti i financiar me fondet e veta							
Programi									
Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2023	PBA Plan Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes	Fakti i Periudhes	Diferenca	Realizimi ne%
600	Paga	231,697,444	265,003,000	265,003,000	287,355,426	181,967,253	169,847,325	12,119,928	93
601	Sigurime Shoqërore	38,880,801	44,922,000	44,922,000	48,810,421	30,770,373	28,510,051	2,260,322	93
602	Mallra dhe Sherbime të Tjera	131,487,512	160,000,565	160,000,565	165,732,454	102,564,289	85,665,457	16,898,832	84
604	Transferta Korente të Brendshme	659,304	5,504,730	5,504,730	5,504,730	3,669,820	434,085	3,235,735	12
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0				0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	14,398,907	11,788,000	11,788,000	12,438,000	9,577,000	9,105,234	471,766	95
609		0	16,685,412	16,685,412	9,498,764	3,231,333	0	3,231,333	0
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>417,123,968</b>	<b>503,903,707</b>	<b>503,903,707</b>	<b>529,339,795</b>	<b>331,780,068</b>	<b>293,562,152</b>	<b>38,217,916</b>	<b>88</b>
231	Kapitale të Trupëzuara	146,811,202	138,630,010	138,630,010	176,202,142	97,619,591	65,793,467	31,826,124	67
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>146,811,202</b>	<b>138,630,010</b>	<b>138,630,010</b>	<b>176,202,142</b>	<b>97,619,591</b>	<b>65,793,467</b>	<b>31,826,124</b>	<b>67</b>
230	Kapitale të Patrupezuara								
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale								
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>146,811,202</b>	<b>138,630,010</b>	<b>138,630,010</b>	<b>176,202,142</b>	<b>97,619,591</b>	<b>65,793,467</b>	<b>31,826,124</b>	<b>67</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>563,935,170</b>	<b>642,533,717</b>	<b>642,533,717</b>	<b>705,541,937</b>	<b>429,399,659</b>	<b>359,355,619</b>	<b>70,044,040</b>	<b>84</b>

**I. BASHKIA KUÇOVË**

**-PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM (01110):**

**Objektivat e politikës së programit:**

- Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerezore në Bashki në mënyrë që të përgjigjen realizimit të vizionit për të ardhmen e qytetit.
- Sigurimi i shërbimit cilësor dhe me etikë ndaj qytetareve.
- Të ofrojë partneritet, koordinim dhe mirekuptim midis paleve duke garantuar mbarevajtje optimale të punës në shërbim të komunitetit.
- Ofrim i shërbimeve mbështetëse për Kryetarin, Komisionet, Këshillin Bashkiak, Kryetarin e Këshillit.



- a. Shërbime statistikore dhe krijim i bazës së të dhënave vendore, publikim i dokumentacionit me karakter publik dhe të dhënave të tjera për çështje dhe shërbime në funksion të zhvillimit të komunitetit. Krijimi dhe zhvillimi i një mjedisi ekonomik, në mënyrë të tillë që të jete sa më atraktiv dhe konkurrues, i cili do të konsolidojë dhe garantojë qëndrueshmëri ekonomike gjatë periudhës afatmesme.
- b. Promovimi dhe mbështetja e biznesit.
- c. Permirësimi dhe zhvillimi i infrastruktures së nevojshme për rritjen e biznesit.
- d. Gjetja e mënyrave më efektive për zgjerimin e bazës së taksueshme të bizneseve dhe të familjeve.
- e. Vlerësim sa më real i detyrimeve të taksapaguesve nga ana e administratës tatimore vendore.
- f. Ofrimi i një shërbimi me cilësi dhe brenda një kohe sa më të shkurtër, në sajë edhe të informatizimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore.
- g. Asistencë dhe këshillim nga administrata tatimore vendore për çdo biznes që kryen aktivitet tregtar si dhe për çdo individ i cili dëshiron të çelë aktivitet të ri.
- h. Administrim më efikas dhe efektivitet i sistemit tatimor, përmirësim i infrastrukturës tregtare dhe ulje e informalitetit.
- i. Krijimi i marrëdhënieve të besimit reciprok midis Bashkisë dhe komunitetit.
- j. Transparencë të plotë për përdorimin e fondeve publike.

Objektivat e institucionit të shprehura në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat janë pjesë e objektivave të buxhetit vjetor dhe udhërrëfyese për zbatimin e buxhetit për çdo program, sektor, punonjës.

1-Për periudhën Janar – Gusht 2024, për sa i përket ofrimit të shërbimeve mbështetëse të Kryetarit të Bashkisë, vlen të theksohet se çdo nismë e ndërmarrë apo çdo akt administrativ i nënshkruar në zbatim të funksioneve dhe ushtrimit të detyrës të titullarit të institucionit është realizuar me konsultimin paraprak, i cili ka konsistuar në ofrimin e asistencës ligjore të Drejtorisë Juridike.

2-Për të njëjtën periudhë, është ofruar asistencë ligjore dhe është bashkëpunuar me Këshillin Bashkiak si edhe me komisionet përbërëse të tij të ndara sipas natyrës së veprimtarisë së tyre për të lehtësuar sa më shumë punët dhe marrjen e vendimeve nga ky Këshill.

3- Në lidhje me publikimin e të dhënave të cilat ndihmojnë në zhvillimin e komunitetit Bashkia Kuçovë nëpërmjet faqes së institucionit ka publikuar zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Kuçovë si edhe njoftime me karakter sensibilizues për qytetaret sa i përket hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve, të dhëna në lidhje me planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve i cili po zbatohet në gjithë qarkun e Beratit për një mjedis sa më të pastër, si edhe shumë aktivitete të tjera me karakter informues sipas natyrës apo qëllimit për të cilin ky institucion është krijuar, të cilat kanë ndihmuar jo pak në zhvillimin e komunitetit që është pjesë e territorit të Bashkisë Kuçovë.

4-Sa i përket publikimit të dokumentacionit me karakter publik për periudhën Janar – Gusht 2024, në total janë marrë 48 vendime nga Këshilli Bashkiak Kuçovë dhe janë publikuar 48 Për një funksionim normal të punës së administratës dhe ofrimin në kohë dhe cilësi të shërbimeve ndaj qytetarëve, janë plotësuar nevojat bazë për kancelari, bojë printerash e fotokopje, shërbimet për furnizimin me ujë, energji, ngrohje, internet, shërbim i higjienës etj, Gjatë periudhës janë mbuluar nevojat për karburant dhe shërbime mirëmbajtjeje për mjetet e bashkisë dhe pagesa në kohë e detyrimeve vjetore.

Janë blerë pajisje zyre në funksion të nevojave të institucionit, mirëmbajtja e ambjenteve të punës etj.

Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore vazhdimisht ka mbajtur kontakte me Komisionerin e Mbikqyrjes së Shërbimit Civil, Shkollën e Administratës Publike dhe DAP në lidhje me shërbimin civil, dhe është zbatuar me përpikmëri çdo vendim i marrë.

Nga ana e strukturës përkatëse, janë kryer kontrolle të vazhdueshme mbi prezencën në punë, në rastet kur janë hasur probleme janë mbajtur proces verbal të përkatëse dhe janë marrë masa



disiplinore për çdo punonjës që nuk ka respektuar orarin zyrtar të punës, apo nuk ka respektuar rregullat e etikës për administratën publike.

Sa i përket rekrutimeve 31 punonjës janë rekrutuar sipas akteve ligjore ne fuqi, 3 në shërbimin civil dhe 28 me emërimë në zbatim të kodit të punës.

Në lidhje me largimet e punonjësve, gjatë kësaj periudhë 20 punonjës janë larguar sipas specifikave të rastit. (14 me dëshirë, 6 dalje në pension).

Bazuar ne Vendimin e Këshillit Bashkiak Kuçovë me nr. 45 datë 20.12.2023 “Mbi kategorizimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve, si dhe të punonjësve administrativë të bashkisë dhe njërive të saj në varësi për vitin 2024”, i ndryshuar, numri total i punonjësve ishte 401, përfshirë dhe Gjendjen Civile.

Është kryer përditësimi i regjistrit të personelit.

Është kthyer përgjigje për çdo shkresë të ardhur nga institucione apo qytetarë, brënda afateve ligjore. Zyra e Informimit të Publikut, ka trajtuar gjithsej 201 kërkesa dhe 69 ankesa.

Njësia e prokurimit kryen procedurat e prokurimit për Bashkinë Kuçovë dhe Njësitë shpenzuese në varësi të saj. Gjate kësaj periudhe janë kryer procedurat e prokurimit për 12 tendera dhe 35 procedura për blerje me vlera të vogla.

Sektori juridik: Bashkia Kuçovë është palë ne cilesine e paditesit, të paditurit si dhe person i trete në 17 procese gjyqësore të cilat i ndjek në vazhdimësi.

#### **-AUDITI I BRENDSEHM PROGRAM 01110:**

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bazuar në ligjin nr. 114/2015 date 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” te ndryshuar, ne zbatim te standardeve dhe kerkesave normative te sanksionuara ne “Manualin e Auditimit te Brendshem ne sektorin public”, miratuar me Urdherin e Ministrisë te Financave me nr. 100 date 25.10.2016, eshte realizuar veprimtaria e Sektorit te Auditimit te Brendshem per periudhen 8-mujore Janar-Gusht 2024 si vijon:

-Ne zbatim te urdher-porosisë se Kryetarit te Bashkise Kuçove, dokumentuar me shkresen 4190 prot. date 11.12.2023, si dhe ne pergjigje te Kerkeses per raportimin vjetor mbi sistemin e MFK, nen drejtimin e Kryetarit te Bashkise, u hartua “Deklarata për “Cilësinë e sistemit te kontrollit të brendshëm ne bashkine Kuçove” dhe u pergatit Raporti vjetor per cilesine e Sistemit te Kontrollit te Brendshem, te cilat u dërguan në DH/MFK ,te Ministrise se Financave, brenda afatit te detyrueshem ligjor, me shkresen percjellese nr.4190/1 prot. date 28.02.2024.

- Ne zbatim te pikes c te nenit 14 te ligjit nr.114/2015 dt 22.10.2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin public”, bazuar ne aktivitetin e dokumentuar dhe raportuar periodikisht, nga Njesia e Auditimit te Brendshem,u pergatit “Raporti i aktivitetit vjetor te Njesise se Auditimit te Brendshem per vitin 2023”,se bashku me plotesimin e pasqyrave shoqeruese,si dhe u dergua brenda afatit te percaktuar me ligj ,ne DH/AB ne Ministrine e Finances, me shkresen percjellese nr.510/1 prot, date 12.02.2024.

-Gjate periudhes 8-mujore Janar-Gusht 2024, ne zbatim te Planit Vjetor te auditimit per vitin 2024, miratuar nga Kryetari i Bashkise me dokumentin me nr. 3179/1 prot. date 16.10.2023, eshte vepruar si me poshte:

1-Ne vijim te misionit te auditimit ne Drejtorine e Zhvillimit Rural, auditim i programuar per vitin 2023, (auditim ky qe e mbylli veprimtarine ne terren ne fund te 2023), nga Njesia AB u ndoqen dhe u zbatuan te gjitha fazat e komunikimit dhe raportimit, duke perfunduar ne fillim te muajit Mars 2024, me Raportin Final te auditimit,, ne te cilin u dhane 13 rekomandimeve te pranuar,ne kuader te permiresimit te veprimtarise se kesaj njesie.

2-Me Programin e angazhimt te auditimit “ me nr. 1973/1 prot. dt.11.06.2024 u realizua auditimi me baze “perputhshmerie” i veprimtarise se Drejtorise se Transportit, Sherbimeve Publike, Sherbimeve Mbeshtetese & Mjedisit. Duke ndjekur dhe zbatuar te gjitha fazat e auditimit, conform kriterëve te percaktuara ne Manualin e AB, u konsideruan ne Plan-Veprimin e D.T.ShP.ShM&M-se per tu zbatuar 16 rekomandime per permiresimin e veprimtarise ne vijim.

3- Me Programin e angazhimt te auditimit “ me nr. 2853 prot. dt.21.08.2024 u realizua auditimi me baze “perputhshmerie” i veprimtarise se Drejtorise se Policise Bashkiake. Ne perfundim te ketij misioni auditimi, u dhane 14 rekomandime per permiresimin e veprimtarise se ketij subjekti



-Ne pergjigje te "Raportit perfundimtar te vleresimit te Jashtem te cilesise se veprimtarise se NJAB" te DH/AB te Ministrise se Financave , u pergatit dhe u hartua "Plan-Veprimi i zbatimit te rekomandimeve te adresuara ne Raportin Perfundimtar", i cili pasi u miratua nga Kryetari i bashkise u dergua me shkresen percjellese nr.1410/1 prot date 03.05.2024

-Ne reflektim te "Plan-Veprimit te zbatimit te rekomandimeve te cituara ne Raportin e DH/AB, u ripunua dhe u perditesua "Karta e Auditimit per NjAB Kucove" e cila u miratua me Urdherin e Kryetarit te bashkise nr.156 date 11.06.2024 dhe u dergua ne DH/AB me shkresen 2184 prot date 24.06.2024.

- Nen mbikqyrjen e Kryetarit te Bashkise, ne bashkepunim me menaxheret e drejtorive/sektoreve u pergatit me seriozitet e pergjegjesi "Plan-Veprimi per zbatimin e rekomandimeve te dhena ne Raportin Final te KLSH 2024", dhe pasi u miratua nga Kryetari i Bashkise, u dergua ne institucionin e KLSH-se me dokumentin nr.2220 prot, date 26.06.2024.

#### **-Të ardhurat:**

Ne mbeshtetje te dispozitave te ligjit nr. 9632 date 30/10/2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" te ndryshuar, Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", si dhe ne zbatim te Vendimit Keshillit Bashkiak nr.37 date 30 /11 / 2023, "Mbi Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore te Bashkise Kucove per vitin 2024".

Drejtoria e te Ardhurave Vendore ketu, ne bashkepunim me Drejtorite e Bashkise qe planifikojne dhe gjenerojne te ardhura, me Agjentet Fiskale te kontraktuar per faturimin dhe arketimin e detyrimeve, ka programuar dhe organizuar punen e perpjekjet ne funksion te realizimit te programit te te ardhurave te percaktuara per periudhen Janar – Gusht 2024.

Ne vijim do te analizojme realizimin e te ardhurave nga burimet e veta te Bashkise, si Tarifate Vendore ( Pastrim, Ndricim , Gjelberim dhe Mirembajtje te Infrastruktures Arsimore), si per abonente familjare dhe per subjektet e biznesit dhe ato ndermarje institucione , te ardhurat nga Taksa e Nderteses, dhe e Truallit si per abonentet familjar, bizneset e ndermarje&institucione, tatimin dhe qerate e tokes bujqesore, te ardhurat nga ndertimet e reja dhe legalizimet, e te tjera vendore, si edhe perfitime nga Taksat Kombetare te ndara, duke i relativizuar kundrejt atyre te planifikuara per Janar-Gusht 2024.

Rezultatet ne vijim jane bazuar ne rakordimet zyrtare mujore me Degen e Thesarit, nga kryqezimi i informacioneve te derguara nga njesite administrative me derdhjet mujore ne Bankat e nivelit te dyte, ne rakordimin faktik mujor me te gjitha Drejtorite e Bashkise qe kontribuojne ne krijimin e te ardhurave,si dhe me akt-rakordimet me Agjentet Fiskale te kontraktuar per faturimin dhe arketimin e taksave dhe tarifave vendore,si Ujesjelles-Kanalizime Berat-Kucove; Posta Shqiptare Kucove; D.R.SH.T.RR Berat, etj.,

Per periudhen Janar – Gusht 2024, kemi kete realizim:

Plani 8-mujor i te Ardhurave	141 598 000 lekë
Fakti 8-mujor i te Ardhurave	133 382 183 lekë

#### **- Realizimi i te Ardhurave per periudhen Janar-Gusht 2024 është 94.2 %**

Duke perdorur metoden e krahasimit per te njejten periudhe, po prezantojme realizimin faktik te 8-mujorit te vitit 2024 me vitet krahasuese 2023 dhe 2022:

Fakti 8 mujor viti 2024	Fakti viti 2023	Fakti viti 2022
133 382 183 leke;	96 338 892 leke;	121 284 471 leke.

Realizimi i te ardhurave per çdo njesi administrative, kundrejt programit per Janar-Gusht 2024 evidentohet si me poshte:

Nr	Njesia Administrative	Programi	Realizimi	%
1	Kucova	116 323 000	114 644 947	98.5
2	Perondi	10 888 000	9 020 262	82.8
3	Kozare	9 478 000	6 698 434	70.6
4	Lumas	4 909 000	3 018 540	61.5
<b>TOTAL</b>		<b>141 598 000</b>	<b>133 382 183</b>	<b>94.2</b>